



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 164, datë 06.04.2023

**PËR
PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË RISTRUKTURIMIT TË GJYKATËS SË
RRETHIT GJYQËSOR LUSHNJË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, nenit 61, 90, 95 dhe 96 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Vendimit të KLGJ-së nr. 131, datë 28.03.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier", Vendimit të KLGJ-së nr. 557, datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”, Vendimit nr. 140, datë 31.03.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit:

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me përbërje:
 - Z. {...}– Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);
 - Zj. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier);
 - Zj. {...}– Anëtar (Zv.Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë);
 - Zj. {...}- Anëtar (Kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier);
 - Z. {...}- Anëtar (Kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë).
2. Komisioni i Ristrukturimit i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, i cili ushtron funksionet, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, që i nënshtrohet riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR